

KONTRATE PER SHITJEN E KUOTES

Ne Tirane, sot me date 28.03.2024, lidhet kjo kontrate per shitjen e kuotes midis paleve te meposhtme:

Shoqëria “ABA HOSPITALITY” SHPK, një shoqëri e organizuar dhe regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, datë 20.12.2023, me Nr. NIPT: M32420016C, me seli ne Rr. “Papa Gjon Pali i II-te”, Ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, kati i 7-te teknik, Njesia Administrative nr.2, Tirane, Shqiperi, Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit “Njësi”, regjistruar ne ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212 me përfaqësues ligjor Z. Andri Kasneci, me numër personal identiteti I30606204L, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

ketej e tutje do te referohet si “**Shitesi**”.

Dhe,

Bashkim Ulaj, shtetas shqiptar, i biri i Isës dhe Zades, lindur më 15.03.1963 në Mamurras, Shqipëri, dhe banues ne Tirane me adrese Rr. “Mustafa Matohiti”, identifikuar me letërnjoftim me nr.personal G30315336U;

ketej e tutje do te referohet si “**Bleresi**”.

Te cilet, deshirojne te hyjne ne nje Marreveshje per transferimin nepermjet shitjes te 19% (nentembehjete perqind) te Kuotave/pjeseve te Kapitalit te cilat zoterohen nga Shitesi ne shoqerine “ABA BLUE BORGO” sh.p.k., nje kompani me pergjegjesi te kufizuar e themeluar dhe ligjerisht ekzistuese ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Rregjistrin Tregetar te Qendres Kombetare te Biznesit me 17.01.2024, me Nr. Unik Identifikimi M41317061B dhe me seli ne adresen: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndërtesa nr. 12 “ABA Business Center”, kati I 7-te teknik, Njesia Administrative nr.2, Tiranë, Shqipëri. Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit “Njësi”, regjistruar ne ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212. 1010. Kapitali i regjistruar i Kompanise eshte 100,000 (njqind mije) Leke. Kapitali eshte i ndare ne 100 (njqind) pjese kapitali, respektivisht 1 deri ne 100 (100-a perfshihet), me nje vlere nominale prej 1,000 (nje mije) leke secila, e nenshkruar plotesisht;

Ketej e tutje do te referohet si “Kompania”;

Bleresi dhe Shitesi, individualisht do te referohen si “**Pala**” dhe bashkerisht do te referohen si “**Palet**”.

Parashtrime:

Duke patur parasysh qe Shitesi zoteron 100% (njqind perqind) te pjeseve te kapitalit ne Kompani dhe Bleresi ka shprehur interesin e tij ne blerjen e 19% (nentembehjete perqind) te pjeseve te kapitalit te mbajtuara nga Shitesi ne Kompani;

Palet bien dakord per sa vijon:

Neni 1

Perkufizimet dhe Interpretimet

1.1

“Kompania”

“ABA BLUE BORGO” sh.p.k. nje kompani me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar rregullisht dhe ekzistuese ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Rregjistrin Tregetar te

Qendres Kombetare te Biznesit me date 17.01.2024, me Nr. Unik Identifikimi M41317061B dhe me seli ne adresen Rr. "Papa Gjon Pali i II-te", Ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, kati i 7-te teknik, Njesia Administrative nr.2, Tirane, Shqiperi, Nr. Pasurie 7/52-N9 e llojit "Njësi", regjistruar ne ASHK, Zona Kadastrale 8160, vol. 36, fq.212;

"Data e Nenshkrimit"

Do te thote data e nenshkrimit te Kontrates se Transferimit/Shitjes te Kuotave; data kur Bleresi do te behet pronari ligjor i Paketes se Pjeseve te kapitalit.

"Palet"

Do te thote Shitesi dhe Bleresi.

"Cmimi i Blerjes"

Nenkupton cmimin e blerjes per Paketën e pjeseve te kapitalit, e cila do te perfshije 19% (nentembedhete perqind) te kapitalit te regjistruar te Kompanise, dhe perfaqeson shumën 19,000 (nentembedhete mije) Leke.

"Paketa e Pjeseve te Kapitalit"

Nenkupton 19 pjese te kapitalit, me nje vlere nominale secila prej 1000 (nje mije) Leke, e barazvlefshme me 19% (nentembedhete perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise.

- 1.2 Ne kete Kontrate, vetem nese konteksti e kerkon ndryshe, fjalet qe paraqesin njejesin do te perfshijne shumetin dhe anasjelltas dhe referenca per nje person perfshin pasardhesit dhe te autorizuarit e lejuar.
- 1.3 Ne kete Kontrate, emrat dhe titujt e neneve perdoren vetem per lehtësi dhe nuk do te merren parasysh ne interpretimin e Kontrates.
- 1.4 Ne kete Kontrate, nje reference e nje marreveshje do te interpretohet si reference e asaj marreveshjeje, dhe ndryshimeve, plotesimeve, te ratifikuara dhe te percaktuara kohe mbas kohe.

Neni 2

Objekti i Kontrates

- 2.1 Shitesi pranon te shese dhe te transferoje te Bleresi titullin e plote te pronesise mbi Paketën e Pjeseve te Kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine "ABA BLUE BORGO" sh.p.k. bashke me te gjitha te drejtat dhe detyrimet te inkorporuara ne to ose qe rezultojne prej tyre, te lira nga cdo pretendim, barre dhe interesa te sigurise se cfaredo natyre, dhe Bleresi pranon te bleje dhe te perfitoje nga Shitesi Paketën e Pjeseve te Kapitalit me Cmimin e Blerjes sic percaktohet ne Nenin 3 te kesaj Kontrate.

Neni 3

Cmimi i Blerjes

- 3.1 Cmimi i Blerjes se 19% te Paketës se Pjeseve te Kapitalit te shoqerise "ABA BLUE BORGO" sh.p.k. eshte ne shumën 19,000 (nentembedhete mije) Leke dhe do te paguhet nga Bleresi pas Dates se Nenshkrimit te kesaj Kontrate.

Neni 4

Transferimi i Kuotave

- 4.1 Shitesi transferon Paketën e Pjeseve te Kapitalit te Bleresi ne Daten e Nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe transferimi do te regjistrohet prane Regjistrimit Tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit.

Neni 5

Deklarimet e Shitesit

- 5.1 Shitesi i deklaron Bleresit si vijon:
 - (a) Shitesi eshte Zoteruesi i 19 % te Pjeseve te Kapitalit ne Kapitalin e Kompanise dhe ka titull te plote ligjor per ti shitur ato. Nuk ka asnje pretendim, barre, marreveshje apo opsion tjeter per shitjen apo transferimin, apo interesa te paleve te Treta ne lidhje me Paketën e Pjeseve te Kapitalit qe ai zoteron ne Kapitalin e Kompanise.



- Nenshkrimi dhe zbatimi I kesaj Kontrate nga Shitesi nuk kerkon asnje autorizim apo miratim tjetër;
- (b) Kapitali i Regjistruar i Kompanise ka nje vlere prej 100,000 (njeqind mije) Leke. Kapitali eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese kapitali, respektivisht 1 deri ne 100 (100-a perfshihet), me nje vlere nominale prej 1,000 (nje mije) Leke secila, te nenshkruara plotesisht;
 - (c) Kompania eshte ne menyre te vlefshme e regjistruar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar e themeluar rregullisht ne mbeshtetje te Ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe e autorizuar ne perputhje me Statutin dhe me Ligjin e zbatueshem te drejtoje veprimtarine e saj kryesore;
 - (d) Asnje Urdher, Vendim apo mbledhje nuk eshte zhvilluar per mbylljen e Kompanise;
 - (e) Asnje nga deklarimet e mesiperme te Shitesit nuk eshte false apo keqdrejtuese dhe per aq sa eshte ne dijenine e Shitesit, nuk ekziston asnje fakt, e cila cenon apo mund te cenoje ne te ardhmen, pronat, asetet apo biznesin e Kompanise, pervec atyre te bera prezente ne kete Kontrate;

Neni 6

Deklarime te Bleresit

6.1 Bleresi i deklaroi Shitesit si me poshte:

- (a) Bleresi ka pushtetin e nevojshem dhe autoritetin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate;

Neni 7

Shpenzimet

7.1 Secila Pale eshte pergjegjese per te mbuluar tarifat dhe shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin dhe lidhjen e kesaj Kontrate.

Neni 8

Njoftime

- 8.1 Pervecse kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, nje njoftim ne zbatim te kesaj Kontrate do te jete ne fuqi vetem nese behet ne menyre te shkruar.
- 8.2 Njoftimet ne kete Kontrate do te dergohen pales se kesaj Kontrate ne adresen, numrin dhe ne vemendje te individit, te percaktuar me poshte:

Per Shitesin:

Drejt: Z. Andri Kasneci

Rr. "Ismail Qemali", Tirane, Shqiperi

Per Bleresin:

Drejt: Z. Bashkim Ulaj

Rruga "Mustafa Matohiti", Tirane, Shqiperi

Neni 9

Gjuha

9.1 Kjo Kontrate eshte hartuar ne 2 (dy) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, te cilat kane vlere te njejte ligjore.

Neni 10

Ligji i zbatueshem

10.1 Kjo Kontrate do te interpretohet dhe zbatohet ne perputhje me ligjin Shqiptar.

Neni 11

Mosmarreveshjet


11.1 Cdo mosmarreveshje qe lind nga ose lidhur me kete Kontrate, ose ne lidhje me interpretimin, vlefshmerine, jo-performancen apo perfundimin, do te zgjidhet nga Palet ne mirekuptimin e ndersjellte, ne rast te kundert Gjykata e Rrethit te Tiranes do te konsiderohet gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre.

* * *


NE DESHMI TE SA ME SIPER, Palet kane nenshkruar kete Kontrate ne daten dhe vendin e shkruar me siper, e cila hyn ne fuqi me nenshkrimin e saj nga Palet.

PALET

Ne emer te Shitesit


Z. Andri Kasneci

Ne emer te Bleresit


Z. Bashkim Ulaj

